

Lajmëtar

ORGAN I KOMITETIT TË PARTIË TË RRETHIT TEPELENË

VITI I 4-t | Nr. 13 (161) | E martë, 26 mars 1991 | Çmimi 20 qindarka

VOTAT TONA PPSH-së

Dita e zgjedhjeve po afron. Ndryshe nga çdoherë tjetër në këtë fushatë elektorale është përfshirë i madh dhe i vogël. Të gjithë diskutojnë, bëjnë parashikime dhe shprehin dëshirën e tyre për Partinë fituese. Është ky një elektorat demokratik, një elektorat ku populli do ta ndjehë plotësisht karakterin demokratik të zgjedhjeve. Ai do të votojë pa asnjë kompleks për atë që dëshiron, për atë që mendon se meriton besimin e tij.

PPSH-ja ka dhe ajo kandidatat e saj në rrethin tonë dhe pretendimin e dëshirën e madhe që ata të fitojnë besimin e popullit, votat e tij për në Kuvendin Popullor. A do ti plotësohet ky objektiv? Përgjigjen e sakët do ta marrim më datën 1 prill. Por kjo nuk na pengon, që duke u nisur nga shumë faktorë, të themi që tani se populli i Tepelenës, në shumicën e tij dërmuese

votat do t'i japë PPSH-së. E themi këtë nga zëri i fuqishëm i zgjedhësve, gjatë takimeve që uzhvilluan kohët e fundit me kandidatët e saj për deputet. Kudo ky zë shpreheu për Partinë e Punës e shokun Ramiz Alia. E themi këtë të bazuar në historinë e popullit të rrethit tonë për këtë periudhë gjysëm shekullore. Është ky popull që në Rrepet e Dervenit, në kohën ku reaksioni ishte në kulmin e vetë u betua «Për jetë me Partinë», është ky popull që e ndoqi hap pas hapi Partinë e Punës pa asnjë lëkundje, duke u radhitur kurdoherë në ballë të çdo sakrifice dhe heroizmi, që dha gjatë viteve të luftës gjysmën e komunistëve, dhe shumë nga bijtë e bijat e tij më të mirë, që nën udhëheqjen e Partisë e komunistët në ballë e transformoi krejtësisht jetën e tij, duke dalë në dritë nga errësira e thellë e së kalu-


arës. Këtë histori ky popull e njeh, e ka shkruar vetë dhe nuk ia shpërfytyrojnë dot kalemxhinjtë fatqej, të kujtdo kallegji qofshin.

Tepelenasi i zgjuar dhe i formuar politikisht është në gjendje të dallojë Partinë e Punës nga ata që në emër të Partisë e njollësën dhe i sollën shumë dëme Partisë. Ndaj ai nuk mund të mashtrohet nga çdo lloj abuzimi që bëhet mbi këtë fakt për përfitime partiake... Përkundrazi ai është i bindur se PPSH e rinovuar është Partia e vërtetë që i do të mirën e që mbrohet interesat e tij prandaj dhe do - tia japë votat asaj, bijëve të tij më të mirë. Pluralizmi partiak dhe vet partitë e opozitës e mësuan atë të njohë më mirë realitetin, të mbrojë e të ruaj të pastër Partinë e Punës, Partinë e bijëve të tij. Nga kjo rrugë atë nuk e lëkundin as manipulimet dhe as presionet.

PERKUJTOHET 13-VJETORI I VIZITES SE SHOKUT ENVER HOXHA NE TEPELENE

Të dielën më 24 mars, shoqata «Bashkimi i veprimtarëve vullnetarë «Enver Hoxha» organizoi në sheshin «Tre heronj» të qytetit të Tepelenës një miting kush-

Tepelenës, Memaliajt dhe fshatrat përrreth merrnin pjesë dhe veprimtarë e përfaqësues të tyre nga rrethet Gjirokastrë dhe Përmet. Fjalën e rastit në këtë mi-



ting 13- vjetorit të vizitës së shokut Enver Hoxha në qytetin e Tepelenës dhe në disa rrethe të tjera të jugut. Në këtë veprimtari krahas veprimtarëve vullnetarë të këtij bashkimi nga qyteti i

ting e mbajti kryetari i Bashkimit të veprimtarëve vullnetarë «Enver Hoxha» të rrethit të Tepelenës Fatmir Gumeni. Në fjalën e tij ai theksoi vendosmërinë e vullnetarëve të kësaj organiza-

te për të mbrojtur veprën dhe emrin e Enver Hoxhës dhe për të ecur në rrugën e tij. Fjalimi i tij u ndërpre nga brohoritjet e fuqishme «Ja të vdesim ja të rrojmë Enver Hoxhën do ta mbrojmë». «Tepelena dhe një herë do të digjet për Enver». «Gjirokastrë e Tepelenë të vendosur për Enver» e tjera parulla të tilla. U theksua vendosmëria e veprimtarëve të shoqatës «Enver Hoxha» për të hedhur votat e tyre për kandidatët e PPSH dhe për të vajtur në këto zgjedhje të para pluraliste në vendin tonë me qetësi e urtësi. Nga tribuna e mitingut përshëndetën dhe përfaqësues nga rrethi i Gjirokastrës dhe Përmetit si dhe veprimtarë të zonës së Kurveleshit, të Lopësit, të qytetit të Memaliajt e tjerë.

Në fund të mitingut me vargjet e këngës «Enver Hoxha tungjatjeta» pjesëmarrësit manifestuan në rrugën kryesore të qytetit.

Korresp. i «Lajmëtarit»

FI TORJA E PPSH-së ME 31 MARS ESHTË E SIGURT



BASHKEDISEDIM ZEMRASH

MBRESA

Pranvera ka trokitur në këto ditë të vullshme diskutimesh, debatesh, mendimesh e polemikash së bashku me fushatën elektorale. Qetë, siç është vetë stina, njerëzit tanë bisedojnë e i hapin zemrën njëri - tjetrit, për idetë e programeve, për reformat e ndryshimeve që përmbajnë në të gjithë shtet të tëra partitë e formuara. Nisur nga fushata dhe rregullat elektorale kanë filluar edhe takimet me zgjedhësit të gjithë kandidatët për deputetë në Kuvendin Popullor.

Për këdo kryefjala e temës në bisedë është se, për kë do të votoj unë, ti, të gjithë ne; se kujt do t'i japim votëbesimin për të përfaqësuar popullin në pushtetin e shtetit pluralist, të pastrin e këtij lloji në vendin tonë.

Kandidatët e Partisë së Punës i kanë filluar takimet me zgjedhësit në të katër zonat elektorale të rrethit tonë, me pjesëmarrje të gjerë të masave punonjëse. Në të vërehet meraku mbarrëpoqullor i të ardhmës së fshatit, të krahinës e të rrethit, për punët e njerëzimit, për unitetin dhe mirëqenien e tyre. Dhe kandidatët e Partisë së Punës për deputetë në Kuvendin Popullor japin vetëm një premtim para njerëzve: Atje ata do të çojnë me besnikëri zërin e masave që do të përfaqësojnë.

Kemi qënë pjesëtarë në shumë takime këto ditë me përfaqësuesit e Partisë së Punës dhe jemi dëshimtarë se si ata i qajnë hallet me popullin bashkarisht, se edhe ata nuk janë të ndarë, dhe as që mund të ndahen nga zgjidhja e problemeve e shqetësimeve të kohëve të fundit. Të katër deputetët popullit i rrethit tonë i njeh mirë, se i ka bijtë e tij dhe, si të tillë, janë mëkruar me shpirtin dhe bujarinë e tij, që ne tepelenasit kemi në traditën tonë. Fajkën e Gramozin, Medinin e Xhevatit i njohin njerëzit tanë për virtutet e tyre të

larta. Si bijë të fshatit në fëmijërinë e tyre, ata kanë pirë ujë në burimet e kristalta të Këndrevicës, të Shëndëllisë e Trebeshinës, kanë fjetur me sharkun e bariut në male dhe kanë lëruar tok me bujkun në arë kur e donte nevoja. Ishte Partia dhe pushteti i popullit që hodhi dorën e ngrohtë mbi supin e tyre, i mori dhe i edukoi, i armatosi me dije e kulturë e i radhiti në armatën e komunistëve. Për këto arsye ajo, si dhe për shumë e shumë të tjerë, u bë për ta, në një farë mënyre edhe prind e edukator. Por le të vazhdojmë më tej me takimet që po bëhen me popullin.

Në qoftë se me kandidatët për deputetë të ndonjë parti tjetër bëhen mjaftë pyetje, e kërkohen sqarime, e kundërta ndodh me përfaqësuesit e Partisë së Punës. Bashkëbiseda në këtë rast merr ngjyra të tjera. Ajo lidhet fund e krye me besnikërinë, devocionin, me reformimin e Partisë, me gjakun e të rënëve nga kuria uniteti, deri në ruajtjen e arritjeve më të mira gjatë asaj rrugë që është bërë. Sa përmend kandidatët këto (e shumë të tjera) shpërthejnë duartrokitjet e thirrjet «Parti - Enver...». Kjo është, më duket mua, vota dhe përgjegjësi e çdonjërit më 31 mars, kur të gjithë do të lëmë vetëm njerin në fletën e votimit. Duke i ndjekur këto takime, populli sikur po e thotë hapur: «Ja vota ime, ajo është për PPSH-në». Fjalët a zemër rrjedhin sa nga një fshat në tjetrin dhe bashkohen të tëra në atë që e quajmë unitet, bashkim, përparim.

Nuk po përmend emra folësish. Jo se nuk dua, por se ju zgjedhës jeni të shumtë që thatë e thoni: Votat tona janë për kandidatët e Partisë së Punës që lindi në zjarrin e gjoksit popullor, u rrit bashkë me ne dhe tashmë që po mbush 50 vjet, di të reformohet, di të rinohet.

ZENEL GAPAJ

*

VOTAT TONA JANE PER

Deputetët tanë

gjithmone mes shokesh



Periodha prej 13 vjetësh pune në minierë, është për mua e mjaftueshme për të vlerësuar personalitetin e drejtorit të saj, Medin Duraj, me të cilin jam njohësish dhe bashkëqytetar. Po pikërisht këtu fillon dhe vështirësia. Ta njohësh një njeri shumë dhe të flasësh për të pak, aq sa të lejojnë mundësitë e kësaj gazete. Sidoqoftë do të them me cil tërsi mendimet e mia se si unë e gjykoj dhe e vlerësoj Medinin, kandidatit për deputet të Kuvendit Popullor të zonës elektorale 202.

Në vitin 1978, pasi mbaroj Universitetin e Tiranës fakultetin gjeologji - miniera filloi punën në minierën e qymyrgurit të Memaliajt si gjeolog dhe në vazhdim si përgjegjës i sektorit të Canajt dhe të Pusit 3. Nuk dua të flas për aftësitë e tij drejtuese dhe organizuese pse vet rezultatet e sektorëve që ai drejtoi për disa vite me radhë janë dëshmia më e mirë për këta tregues. Por dua të theksoj vlerësi-

min që i bëri Medini kësaj periudhe të punës së tij në minierë: - Mes punëtorëve, - pasi u ktheva nga universiteti, unë kreqa një shkollë tjetër të vërtetë me jo më pak vlera se e para. Punëtorët e nëntokës - thotë ai - më mësuam se si të drejtojmë e të komunikoj me njerëzit si të njoh dhe të zgjidh kërkesat dhe shqetësimet që kanë ata, më mësuam të jem komunist i vërtetë. - Dhe komunistët e minierës, duke parë tek ai, kuadrin që kërkon koha, militantin e vendosur për vijën e Partisë, njeriun e respektuar nga masa e punëtorëve, e zgjodhën në vitin 1987 sekretar të Komitetit të Partisë të minierës, kurse zona elektorale 203 deputet të Kuvendit Popullor. Nuk ishte i rastit propozimi i punëtorëve nga salla për caktrimin e tij si drejtor i minierës heroinë. Ishte besimi i tyre i madh tek aftësitë e tij drejtuese dhe dëshira e tyre për ta patur dhe më pranë.

Kur e zëvendësova në detyrën e sekretarit të Komitetit të Partisë pata një merak të madh dhe shqetësim: a do të isha në gjendje t'i përgjigjesha kësaj detyre në ato nivele që iu përgjigj ai. Po shpejt, shumë shpejt u lehtësua. Medini me gjithë detyrën dhe me një ngarkesë të madhe punë m'u ndodh gjithnjë pranë. Duke punuar së bashku me të, në zyrë, në galeritë e nëntokës, në sektorët e sipërfaqes e kudo, unë e njoha dhe më mirë shokun tim; në

radhë të parë si specialist me horizont të gjerë profesional, si drejtues të thjeshtë, të ndershëm dhe të komunikueshëm, me iniciativë dhe të sakrificës, që di dhe të reflektojë dhe të tërhiqet kur gjykon se gabon. Çelsin e zgjidhjes së problemeve Medini e ka kërkuar gjithmonë mes shokëve të tij të punës, kuadrove dhe punëtorëve të thjeshtë. Midis tyre ai e ka ndjerë dhe e ndjen gjithmonë votën të gëzuar. Këtë e thekson vet ai, këtë e kemi parë dhe ne në tërë qënien e tij.

Në këtë legjislaturë Medinin e ka propozuar për kandidat për deputet të Kuvendit Popullor zona e vendlindjes së tij, ajo e Buzit. Për këtë ai ndjeu një kënaqësi të veçantë. - I jam borxhllil krahinës sime-ta. Mund të bëja më shumë për të zgjidhur disa kërkesa të tyre të cilat i kam njohur por nuk i kam vlerësuar sa duhet. Propozimi i tyre më gëzoj pa masë, jo se më vunë kandidaturën për deputet, por për besimin që kanë tek unë. Dhe Medini po mendon seriozisht për zonën e tij, për atë zonë nga vijën disa dhjetra punëtorë në minierë, për xhadenë që kanë vite që e kërkojnë, për ambulancën, për eliminimin e defekteve të rrjetit elektrik, për t'i përfaqësuar ata denjësisht në organin tone më të lartë.

Unë që Medinin e njoh mirë, kam shumë besim tek ai.

GEZIM BIJO

Buzi ka qenë dhe mbetet me PPSH

Në zonën e Buzit gati kanë përfunduar takimet me kandidatit për deputet të PPSH për Kuvendin Popullor. Si asnjë herë tjetër sallat dhe, mjediset e tjera

Kurtjez : Në takimin me deputetin morën pjesë 90 për qind e votuesve, ishin të reja, të moshuar e sidoshoqe. Mes duartrokitjeve e mori fjalën kandidati për deputet Medin Duraj e pas tij folën Ylli Demaj, Isuf Demaj, Qamil Minaj, Nafije Bilaj e tjerë. Kooperativisti Jonuz Leka tha: S'dua të bëj koment për programin elektorale të PP se ai është i qartë si drita e diellit. Ne, si kurtjezot e dimë se ku

Komar: Fshati ka mbi 200 votues. Vatra e kulturës ditën e takimit ishte plotë e përplotë. E morën fjalën Maliq Pasha Xhevdie Ahmeti, Reshat Myrtaj, Vito Agaraj e tjerë. Ata theksuan kujdesin e madh që ka treguar Partia për transformimin e fshatit dhe zhvillimin e tij. Krahaskan të krahuarën Komarit me të sotmen e tij por patën dhe kërkesa për të ardhmen e

Arrëz e Vogël : Në takimin me deputetin e PPSH mori pjesë gati i gjithë fshatit, veçanërisht gratë ishin të parat që zunë vend në sallë.

Është kjo vijim e një tradite per gratë e Arrëzës së Vogël. Në ngjarjet e mëdha historike ato janë në ballë. Kështu u radhiten ato në vitet e zjarra të luftës për liri. Dhe votimet e 31 mar-

ku u zhvilluan këtu, ku u mbushën plot me gratë dhe kudo e njëjta bota. Uje Parti - Enver - tona janë për PPSH.

kemi qenë dhe ku kemi rritur nën udhëheqjen e tësë së Punës, e dimë që në të cilën ajo na Prandaj pse kemi këtu ndje votat tona fshatit, t'ia japim kandidatit PPSH për deputet në Kuvendin Popullor.

Pjesëmarrësit e mirat propozimin e Jonuzit një brohoritje entuziaste. Votat tona Partisë së Nës.

fshatit. Komarjotët kërkon një central të vegjetim fonik për fshatin e tyre dhe telefona në shërkëruan pausjen e vatrës kulturës me mjete të reja për arzetimin e rinisë. Kësaj normale që shpesh vëlin e kulturës së kooperativëve të këtij fshati në fund i njëjti konkludon e njëjta dëshirë. Votat kandidatit e PPSH.

si përbejnë një ngjarje madhe historike për Partinë e Punës dhe për gjithë popullin shqiptar. Ka njeri nuk e kupton këtë? Vë në provë pushtetin e pushtetit thellësisht e prap në zemrën e tij. Gratë në tonin takimit me të e tyre. Si dhe në bujtë ato janë për krah Partisë.

RUSHIT MULLARU

Kjo është Partia ime

SKICA

Kisha dëgjuar se në Damës, shumë kohë më parë, aksidentalisht dy vëllezër nga fisi i divindarajve, i-nshin gjymtuar. Njeri kishte lënë të dy duart ndërsa tjetri vetëm një. Disa vite më parë i kam njohur nga afër ata. U kam njohur shpirtin punëtor, ndërgjegjshëm, bujarinë. Më vinte mjaft keq për Durimin që s'i kishte krahët, dhe bëja pyetjen vetes: «Si ushqehet, si jeton dhe si punon ky fatkeq?». Përgjigjen ma dha shumë shpejt dhe me interesim i tij, tek e shikoja të shpejtonte nga njëra parcellë në tjetrën si rojtari i pronës së përbashkët. E kryetesh dhe asnjëra prej kryesive të kooperativës, për

ndershmërinë dhe ndërgjegjen e lartë nuk e kishte lëvizur nga kjo detyrë. I kështu Durimi doli edhe në pension. Po ç'ma kujtoi në këtë pragvitim atë?

Një prej veteranëve të rrethit shkoi disa ditë më parë në Damës. Në sallë ishte edhe Durimi. U ngrit e tha vetëm kaq: «Unë do të votoj për PPSH-në. Të mos harrë ajo unë do të lypja, familje s'do të kisha krijuar. Faresha do të më ushqente me kafshita buke. Ndërsa kjo parti më bëri të barabartë midis të gjithëve. Partia e Punës është partia ime, - tha. Dhe u ul me djersë në ballë, ashtu siç punoi tërë jetën.

RAMO DHIMA

DUKE PRITUR 31 MARSIN

REPORTAZH

Çdo ditë që vjen e sjell gjithnjë e më pranë 31 marsin. Kjo e sotmja, përshembull, e shkurtor javën e fundit edhe me një ditë tjetër. Gjithsesi ka mbetur fare pak kohë për të mbledhur tek kjo ditë, nga mbi e zakonshme, por që qysh siç e tutje do të hyjë në histori si ditë e zgjedhjeve të para pluraliste në vendin tonë. Partitë e ndryshme politike dhe subjektet e tjera elektorale i shpallën tashmë përfundimisht kandidatët e tyre për deputet në Kuvendin e ardhshëm Popullor. Gjithëkrah vendi kësaj ditë.

Kush do të fitojë në zgjedhje? Si do të jetë pullamenti i ardhshëm? Po Qeveria e re? Ç'rol do të luajë partia fituese dhe partitë e tjera në jetën politiko-shqetërore të vendit? Ç'fjalim do të ketë shteti paraqitë dhe ekonomia e vendit? Janë këto disa pyetje që i ndesh jo dhe aq njerëz praktikë mblodhesh se sa në librat e zakonshme midis njerëzve. I lejojmë shqetësimet të tilla në sytë e cilës do që ndjen brenda votës një merak apo një përkujdesje tjetër.

Disa ditë rrosht këto ko-

hë e fundit, veterani i rëndosur Elmaz Teme konstaton qysh herët në këto ngjarje kalante për të e Tepelenës e merrte të tij rregull drejt ish-Damës e Kashutit. Për kishte natyrë përcaktuar njëherë atje. Në mendjen disa fshatarëve ishte kumbi i se keqes e të grëcate ndërgjegjshme shtë ndonjë që duke i shpirt agri intervista partitë hidhte benzine zjarrit mar Temeja, duke punëvet shtu siç di e do ai për pullin e fiku këtë zjarri nuk në këtë pragvitimësh e çdo përmirë i kësaj Elmazit

KANDIDATET E PARTISE SE PUNES *

Programi i PP - e ardhmja jonë

Tubimet e mëdha sjellin me vete diçka të re në jetën e njeriut: një vendim për problemet më jetike të vendit, një rrahje mendimesh për një hap më tej drejt së ardhmes, një bilanc për atë që kemi realizuar deri tani. Me këtë mendim u mbledhën në shtëpinë e kulturës "E. Gjini-shi" hormovitet për t'u takuar me kandidatin e Partisë së Punës për deputet në Kuvendin Popullor, Gramoz Rucin.

Në fjalën e tij ai u tha: "Është hera e parë që propozohem për deputet dhe e kam për nder që jam kandidat i Partisë së Punës, i asaj partie që ju të gjithë e njihni mirë...". Pas tij e morën fjalën zgjedhës të moshave të ndryshme, që diskutuan me ndjenjën e përgjegjësisë për programin e Partisë së Punës e veçanërisht për atë pjesë ku filletit

për fshatin. Folën Muho Rudi, Dulo Sinani, Isuf Skendi, Hadër Dina, Muho Osmeni, Bazo Tota, Garentina Lamaj, Astrit Kucaj, Lumturi Camaj e plotë të tjerë.

- Ne, tha diskutanti M. Rudi tek programi i PPSH shohim të ardhmen tonë sepse ajo kurrë nuk na e ka patur me hile, por ka luftuar gjithnjë për të mirën tonë - Trojet tona janë djegur e zhuritur disa herë, tha B. Tota, dhe qindra djemë për këto troje na janë vrarë. Vetëm në vitet e Partisë, - vazhdoi ai - fshatin tonë e ndertuam dhe e zbuluam. - Programet e disa partive të tjera ne grave, tha G. Lamaj, - jo vetëm që nuk na lehtësojnë por na ngarkojnë akoma më shumë me punë prandaj ne mbështetim programin e PPSH dhe do të votojmë për të.

ZAHO BALILI

POEZI

Kënga e gjakut

(POLEMIKE)

Në rrugën e dritës, unë jam kalorës e erërave të kuqe Maratonist i origjinës prindërore ku lindi kënga e gjakut Vropoj duke ëndërruar një çlodhje në zemrën e lules Ndërkohë ti bëhesh shigjetë dhe më qëllon pa shkak.

Pastaj, midis meje dhe teje një dorë hedh breshër të zjarrtë Për të shplarë rrugën a për të ndezur gjakun?!

- qartë s'e di... Mbi lumë, ura që na lidh me njëri - tjetrin po tronditet Besën, zemrën e gjakut i çove në vetvrasje kështu!

M'ik prej këngës së gjakut ti që iu vodhe zemrës prindërore! Kënga e gjakut ka emrin e dashurisë dhe sytë e njeriut... Dashuria asnjëherë nuk është zgjuar prej thirrjeve të tua Ç'është kjo lojë mes flakës dhe këngës së gjakut?!

FETI ZENELI

Ne, një grup PIKTORËSH të rrethit tonë, duke biseduar me njëri tjetrin, menduam që t'i bëjmë të njohur opinionin të rrethit se votat tona dhe të familjeve tona do të jenë për kandidatët e PPSH-së. Në këtë konkluzion të përbashkët ne arrijmë jo duke parë thjesht se c'le mira i ka prurë Partia e Punës popullit, por perspektivën që i hap programi i saj së ardhmes së atdheut, sigurisë që ajo i krijon pava varësisë dhe lirisë së vendit. I referohemi vetëm një fa-

PER INTERESAT E POPULLIT

kti që ajo i përbahet në programin e saj: mosshitja e tokës. Duket si gjë e vogël por është në të vërtetë i përmasave të pakufishme. Të shesësh një copë tokë një individ, apo shoqëri të huaj, do të thotë të shesësh atdheun. A nuk e kanë pësuar këtë gjemë ato shtete që u futën në një tregti të tillë? Kështu u shpikur dikur para klimës dhe Shën Naumi ynë. Ka dhe plotë çështje të tjera në programin e Partisë që

tregojnë se ajo është shumë më afër interesave të atdheut dhe të popullit se partitë e tjera politike. Ndaj dhe ne kemi vendosur të votojmë për PPSH.

PIKTORËT : Alosha Bilbili, Astrit Beluli, Josif Gjici, Ilir Kalemi, Artan Hamzai, Arben Dogani, Xhevat Progonati, Artur Hasani, Anesti Hadëri, Agim Sadiku.

Qesarati do të votojë për kandidatin e PPSH-së

Sa më shumë afrohet dita e votimeve aq më tepër rritet dhe besimi ynë për fitoren e madhe në këto zgjedhje elektorale. Ka gati një mendim unik që votat t'i japim për PPSH-në. Dhe kjo nuk është thjeshtë një dëshirë e çastit por një konkluzion i bazuar në perspektivë, te programi i Partisë shikojmë të ardhmen e ekonomisë së kolektivizuar dhe progresin e shoqërisë sonë.

Mbi bazën e të ardhurave që kemi siguruar nga kjo

ekonomi dhe nga burimet e tjera shtetërore, mbi 75 për qind e familjeve kooperativiste kanë ndërtuar shtëpi të reja. Fshati po furnizohet me ujë të pijshëm derë më derë e mirëgenia e popullit nuk ka asnjë të krahësuar me të kaluarën. Gjithë zona e Qesaratit ka patur vetëm një shkollë fillore kurse tani kemi një shkollë të mesme dhe në çdo fshat shkollë 8-vjeçare. Është vështirë të rradhisim transformimet e mëdha që pësoi

fshati ynë në vitet e pushtetit popullor, në vitet e Partisë të cilat politikanët e dështuar të PD-së mundohen t'i errësojnë. Por populli arritjet i di, i përjeton ndaj dhe është i vendosur të eci në rrugën e PPSH-së e t'i japë asaj votat e tij.

Reshat Cela, Mitat Shehu, Izet Hysi, Gëzim Sina, Pëllumbë Gërbi, Haxhi Danaj, Nure Bakaj, Liliانا Kasa, Naim Meta, Shefqet Gërbi, Surja Sina, Shefiko Kamberi,

Jo vetëm të punës

Në kooperativën bujqësore të Niviceës, shoqet përbëjnë mbi 60 për qind të forcave të punës. Por ato s'janë vetëm punëtores të mira po edhe një forcë e madhe shoqërore. Njihën niviciotët si amvisha dhe nikoqire të zonja, ashtu sikundër dinë të endin në tezgjah punimet prej leshi që konkurojnë me ato të punuara në repartet e specializuara artistike.

Korresp. i "Lajmëtarit"



një akt i madh që meriton të shkruhet e të njihet hollësisht. Është pak që në një situatë të tillë të tensionuar gjëmën ta kthesh në fitore; ta bësh edhe kundërshtarin që të të admirojë. E shikoni ç'forcë ka burri i mençur!...

- Kohët janë të vështira, - tha një ditë në Kurvelesh. Omer Hajnaj, - po askujt nuk i falet të gabojë. Tjetër gjë ishte koha e luftës. Atëherë gabojë edhe pa dashje, ndërsa sot gabon vetëm ai që e ka një qëllim të tillë.

Të ruhemi nga gabimet! Një thirrje që duhet t'ja bëjmë gjithnjë e më shpesh vetes tonë. Aq më tepër tani që do të afrohem para kutisë së votimit. Kujtoni se çdonjeri ja jep jetës së tij

votën, ja jep të ardhmes.

- Unë votoj për kandidatin e Partisë së Punës, - na tha një ditë në Salari, Golik Kapaj, - jo sepse jam komunist, por se shoh tek programi i kësaj Partie perspektiva të shkëlqyera.

Dikujt edhe mund t'i erren sytë në dhomën e fshatit të votimit. Një pakënaqësi individuale apo një mosmarrëveshje personale, që mund të sillt në kopërmend qëllimisht në kohën kur je duke vështuar mbi fletën e votimit bën që ta spostosh penën siç spostohet timoni në duart e shofërit nga xhadeja e keqe. Partia e Punës i ka mësuar gjithnjë njerëzit e saj, që sa herë i kërkojnë interesat e mëdha të popullit dhe të atdheut, të triumfojnë mbi vogëlsirat. Mbi këtë bazë janë ngritur jo vetëm aktet

e shkëlqyera të njerëzve të devotshëm, por është formuar edhe karakteri i tyre.

- S'duam më tokë e bagëti në oborr, se ndryshe grryejmë nga themelet kooperativën, - tha në një mbledhje të këtyre ditëve Qamil Minaj në Kurtjez. Është ai fshatar që deri dje rrinte dy orë duke diskutuar për një vijë uji. Sot ai me pak fjalë të jep mend se si mund të mbahet e të eci përpara kooperativa, shteti e shoqëria.

Diskutimi i mësipërm mund të jetë bërë gjatë takimit me kandidatin për deputet, apo në një mbledhje tjetër. Kjo pak rëndësi ka. E rëndësishme është të nënvizohet lidhja e drejtëpërdrejtë e kësaj thënie në datën 31 mars, me hedhjen e votës për Partinë e Punës,

programi i së cilës përmbush kërkesat e fshatarit që diskutoi aq bukur.

Në fund të fundit, vota është betim. Pushteti ynë i ka rrënjët në betimin e popullit për t'i shkuar pas Partisë së Punës. "Partia e Punës i ka tërësisht të sajat votat e zgjedhësve në Horrovë, sepse fshati ynë ja ka dhënë me kohë besën asaj, ndaj më kot shpesojnë të tjerët!..", i premtoan hormovitet kandidatit të tyre për deputet në takimin që ai pati këto ditë me ta.

Takimet e kandidatëve për deputetë të Partisë së Punës në rrethin tonë janë duke përfunduar. Pak a shumë një premtim "hormovitçe" këta kandidatë e kanë marrë kudo. Tashmë nuk e kemi dhe aq të veshë tirë për t'ju përgjigjur py-

tjes "kush do të fitojë në këto zgjedhje?".

Megjithatë 31 marsi do edhe 4-6 ditë që të vijë. Përmasat e kohës këtu s'kanë ndonjë rëndësi. Rëndësi kanë përmasat e zemrës e të mendimit: ç'vend ka zënë në to Partia e Punës. Se edhe demokratizimi, proces që e shpalli dhe e udhëheq Partia e Punës është pararasëgjithash një element shpirtëror. Është trajtë e shpirtit dhe e mendimit të lirë. Pra, ruajeni veten dhe mendimin e lirë nga imponimet, manipulimet, infeksionet e vjetra, nga të pakënaqurit e reaksionarët. Na gëzoftë të gjithëve ky fryt i parë i pluralizmit! Se kështu kemi për t'i shërbyer më mirë atij. Qoftë e mbarë kjo dita e 31 marsit!...

GJON KROI

Përgjigje kritikave

Anëtar të PPSH-së
s'të bënë tesera

Në shkrimin me këtë titull të datës 19.3.1991 autori (Korresp. i Lajmëtarit) ngrinte një varg problemesh lidhur me diskutimin tim dhe në tërësi qëndrimin tim në mbledhjen e këshillit popullor të rrethit dhe në ekonomi. Unë dua të sqaroj opinionin se ndoshta për ndonjë gjë dhe mund të jem nxistuar gjatë fjalës sime në mbledhje por kam qenë dhe jam për konsolidimin e kooperativës, nuk jam dakort me marrjen e bagëtive nga ekonomia dhe vet nuk kam dhënë shembullit të keq në këtë drejtim. Si komunist kam luftuar dhe do të luftoj për fitoren e PPSH në zgjedhjet e 31 marsit dhe në përgjithësi për zbatimin

e detyrave aktuale dhe të perspektivës që do të na ngarkojë Partia jonë. Është dhe përpjekja ime që Lab-Martalozzi fill pas mbledhjes së këshillit i çoi bagëtinë në stanin e kooperativës. Ndjeje se si komunist duhet të luftojë me shumë për forcimin e organizatës - bazë të Partisë dhe në tërësi për mbarëvajtjen e ekonomisë. Si komunist dokumentin e Partisë nuk e mbaj për formë por atë jam gati ta mbroj me jetën time siç jam gati të mbroj dhe idealin e PPSH se cilës i përka.

Kritikën, megjithatë pak e tepruar, e vlerësoj si ndihmë.

XHENET SULA

PERSE NUK I LINI FEMIJET
TË GEZOJNE !?

Pak ditë më parë në shtëpinë e kulturës "M. Matohiti" u zhvillua festivali i këngës '91 për fatosën e pionierit të rrethit. Shokët drejtues të festivalit me udhëheqës artistik A. Çunaj duhet thënë që në fillim se kishin punuar me seriozitet dhe pasion. Kjo u duk në nivelin e lartë artistik të mjaft këngëve. Por në natën e vetme të shfaqjes atmosferë na u duk jo e plotë, jo e gëzueshme dhe jashtë etikës që kërkon bota feminoe. Ndërkohë që rrugët e qytetit, klubet, lokalitet madje dhe apartamentet ziejnë nga debatet, llalet, kundërshtimet gjer vonë në mbrëmje, fare pak prindër dhe akoma më pak mësues dhe edukatorë u kujtuan të vinin dhe të gëzonin së bashku me fëmijët.

Përse harrojnë ata se fëmijët e tyre kanë nevojë për dialog të zjarrtë e koka të ndezura më pak, se sa për gëzime. Ata bashkë me bukën e përditëshme kanë nevojë të qeshin e të gëzojnë. Edhe në hyrje të sallës mungojnë mësuesit, edukatorët apo drejtuesit që duhet të bashkëpunonin me festivalin. Kaq shumë qenkan "trembur" shokët e shtëpisë së kulturës dhe ata të komitetit të rinisë sa që paskan thirrur "shaxhi policit" edhe për këto krijesa të brishta, se mos u prishin rregullin?

Festivali vërtet ishte i pionierëve dhe fatosave, por nuk mund të justifikohet mungesa e mësuesve dhe edukatorëve të të dy qyte-

ve tona. Përse nuk vijnë ata të krenohen me artistët e vegjël? Kuptohet se çfarë solli vlerësimi i tillë. Nuk merrej vesh nëse këndohej në skenë apo në sallë. Duar-trokitjet më tepër ngjajnë me fërshëllima. Dikush bërtet, një tjetër qëllon me sende shokët dhe kështu vazhdon loja që duket se është pjesë e shfaqjes.

Ajo që na çudit më tepër është se në sallë apo në platenë e rezervuar, krahas të tjerëve mungojnë edhe shokët e rinisë. Duke dalë së bashku me Avni Lakon, drejtor i shtëpisë së pionierëve të Enverit pyes mos vallë fushata elektorale, debatet partiake u hëngrën kaq shumë kohën njerëzve për këtë festival? Madje edhe në juri janë vetëm dy shokë të shtëpisë së pionierit dhe disa fëmijë.

Vështroj fytyrat e fëmijëve që janë duke dalë. Ato sikur nuk e kanë atë kënaqësinë që kishin pritur prej kohës. Dëshifrojnë në to një gortim të singërt dhe të pafajshëm fëmijënor për të gjithë ne të rriturit; zyrtarët, prindërit, edukatorët: "Mos i harroni gëzimet tona, mos harroni se në mungesën tuaj në llozhat e sallës mungoi diçka edhe në mbasaditen tonë". Le t'i ndihmojmë me shumë ata që ta gëzojnë moshën e tyre të bukur, pa u dhënë asgjë nga zymtësia dhe vrazhdësia e ditëve të tensionuara që përjetojmë ne më të rriturit.

GEZUM REDHAJ

U RRIA ME TY PARTI

U rria me ty Parti e Punës e kurrë nuk të quajta njerë. Por ja që disa përlivane labin e labin tërë ditën kundra teje me llojlloj provokimesh.

Bëhu me PD-në që të shijosh karrierën, - desht të turbullonte mendjen njeri prej tyre; e më pas vazhdoi: ti je me arsim të lartë, ke dhënë provimet pasunivertare dhe mbete 28 vjet mësues, s'të bënë të paktën as nëndrejtor.

Mbas dy ditësh një tjetër "korife" u fut drejt e në thelb. - Motrën ta vrau Enveri, - më tha. Nga e di ti, - ia ktheva. - Si nuk e di kam, - vazhdoi, Enveri bëri luftën dhe atje derdhi gjakun lulja e rinisë. Të mos

bëhej luftë, nuk do të kishite gjak e motra jote do të ishte e gjallë.

Të bukur mendje që paske o "demokrat" i mjerë! Populli ynë të ms bënte luftën për të bëhej ortak me nazifashizmin në kurriz të popujve të tjerë. Me të tilla mendje ata duan të shkulin nga zemra e popullit dashurinë për Partinë dhe Enver Hoxhën. Mendoj se në emër të dikuit apo edhe të shitur tek dikush, ata provokojnë e ndërsejnë në këtë fushatë elektorale. Me sa më thanë, unë u kthej përgjigje se ajo që bëjnë s'është veçse një "politikë" e dështuar. Sa për Enver Hoxhën ju them se, vërtet që ai ka 6 vjet vdekur por nga

Kopliku deri në Sarandë, ri i popullit gjëmoi: "Ja vdesim, ja të rrojmë Enver Hoxhën do ta mbrojmë". Vota ime, ashtu si e shpallim intelektualëve të tjerë ndershëm, është për kandidatin e PPSH-së. Arsyeja qartë: Ti, Parti e Punës gjakun e dëshmorëve nuk bën ujë, djersën e ndershme të popullit nuk e merr, se nuk mbjell farën përçarjes dhe ligësisë në zënë dot vend mes bive tuj. Janë me qindra ata që torbën e pakënaqësisë e la dhin në Vjosë kur është pa për fatet e kombit, ndërsa votën e hedhin për Partinë - zemër.

KRENAR PROCONAJ

KUJDES NGJA ASTRIT CACAJ!...

Në një fletë - rrufe vendosur të shtunën e kaluar në qytetin e Tepelenës nga një farë Astrit Cacak kërkoj heqja e kandidatursë së dy deputetëve të PPSH, Fak Cinaq e Medi Duraj dhe shkarkimi i kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të KP të

rrethit, Gjergji Velo sepse kështu i qe mbushur mendja atij. Madje, Astriti është i vendosur t'ja kërkojë këtë jo vetëm Këshillit Presidencial, por edhe OKB-së (!) Zoti e ruajt Peres de Kuelarin nga fletë - rrufetë e Astrit Cacajt!

Vlerësojeni seriozisht të sinjalizim, dhe ju, të shur qytetarë! Astrit Cacak nuk është njeri dosido; i bën pjesë në sërën e lartë të seksionit të PD - së 3 Memaliaj!...

LIÇO VESHI

Ti, zoti Ilir Meço, nuk di se ç'është
kooperativa bujqësore!?

nat. Natyrisht, ti që nuk shikon përtej telave të PT, nuk mund ta dish se në Progonat ka tre vjet që është ndërtuar punishtja me një kapacitet që plotëson përpunimin e qumështit të gjithë zonës së Kurveshit. Pretendon se paske marrë mendimin e masës për prishjen e kooperativës. Mendimin e masës jo zoti Ilir, nuk e keni marrë. Mundet të keni bërë ndonjë bisedë private me ndonjë individ në Progonat. Ne e kuptojmë se ethet elektorale të kanë verbuar nga sytë e nga

gjykimi dhe atë që është bardhë mundoheni ta zë zezë.

Duam të të themi se progonatasit, si gjithë kooperativistët e Tepelenës mshkojnë pas mendjes të Progonatasit do të forcojnë kooperativën e re do të arrijnë rezultate më të mëdha duke mbështetur unanimisht progonatin e PPSH siç do të mbështesin dhe deputetin e s

Nga aktiviteti i komunistëve dhe kuadrove të ekonomisë së Progonatit

Në ç'dyer po troket PD-ja ?!

Fushata elektorale dhe për seksionet e drejtuesit e PD-së është në kulmin e vetë. Në këtë drejtim nuk ka asnjë çudi. Ajo që tërheq vëmendjen janë dyert ku po troket PD-ja për të siguruar simpatizantët dhe për-krahësit e saj. Dhe këto dyert janë në radhë të parë ato që në vitet e luftës i kthyen pushkën popullit e në vonë pushtetit të tij.

Realisht kjo puna e tyre në qoftë se u pëlqen të vazhdojnë të mbajnë në kurriz njollën e zezë. Por për një gjë nuk na vjen mirë që ka dhe njerëz të tjerë që për hir të një pakënaqësie të vogël, për shkak të mosplotësimit të një kërkesë nga ana

e organeve të pushtetit të Partisë i kthejnë krab pushtetit të popullit. Kështu njerëzve u themi: Shërmos u nxitoni, nuk të PD-ja ajo që mbron interesat e popullit, interesat e saj, interesat e njerëzve të shtëpitë. Mos veproni kështu që të mos thoni sërë "kemi bërë ne". Bëni pyetjen vetes: Pse ish të klasuarit e vërtetë po thurrrin hosanara PD-së na bëhen "demokratë" flaktë.

Demokracia që nisi me iniciativën e PPSH. Shprehja që ka nisur rrugën e Evropës është në duart tuj, ja, në duart e popullit nëntor.

YMER STOK